



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 830/5 Prot.

Tiranë, më 4/6 /2012

Lënda: Rekomandim për ,“Albania Explorer” sh.p.k Tiranë

REKOMANDIM
Nr. 15 ,datë 04/06/2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit ,“Albania Explorer” sh.p.k Tiranë

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit,“Albania Explorer” sh.p.k Tiranë me objekt:

- Mbledhja,përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale për subjektet e të dhënave personale që i përkasin kategorisë “Klientë”.
- Verifikimi i ligjshmërisë dhe i përputhshmërisë së përpunimit të të dhënave personale për kategorinë “klientë” në lidhje me proporcionalitetin, bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008“ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Verifikimi i procedurave të realizimit të mesazheve promociionale të kryera nga kontrolluesi drejt subjekteve të ndryshëm të të dhënave personale.
- Verifikimi i procedurave për marrjen e pëlqimit për dërgimin e mesazheve promociionale, të kryera nga kontrolluesi drejt subjekteve të ndryshëm të të dhënave personale.
- Verifikimi i masave që ka marrë kontrolluesi lidhur me sigurinë e të dhënave personale të kategorisë “klientë” bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- 1) Kontrolluesi nuk ka ndonjë dokument në të cilin merret pëlqimi specifik i klientëve që paraqiten në zyrën e tij për pranimin e mesazheve promovionale përmes adresës së tyre elektronike.
- 2) Kontrolluesi për klientët që aplikojnë në websitin bookinae.com, merr një pëlqim të përgjithshëm për përpunimin e të dhënave personale të tyre dhe nuk i krijon qartazi mundësinë të shprehin pëlqimin e tyre specifik lidhur me dërgimin e mesazheve promovionale në adresën e tyre elektronike

Marrja e pëlqimit specifik nga klientët që paraqiten në zyrat tuaja është detyrim i rëndësishëm ligjor, pas informimit në mënyrë të plotë të klientëve (subjekte të të dhënave personale) për qëllimet e përdorimit të të dhënave të tyre personale, si dhe për dërgimin e mesazheve promovionale.

Marrja e pëlqimit për pranimin e mesazheve promovionale përmes websitit bookinae.com duhet të bëhet në mënyrë të qartë, ai nuk duhet të kushtëzohet me afrimin e shërbimit.

Duhet respektuar e drejta e klientëve për të vendosur nëse duan apo jo të marrin mesazhe promovionale duke pasur gjithnjë përparësi respektimin e privatësisë të tyre.

Në këto kushte vlerësoj se është shkelur ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, neni 6 pika 1 germa ‘a’,

1) te dhënat personale përpunohen vetëm:.....a)nëse subjekti i te dhënave personale ka dhenë pëlqimin...

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

- 1) Në zbatim të nenit 6 pika 1 germa ‘a’ të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të merret pëlqimi i klientëve që paraqiten në zyrat tuaja për pranimin e mesazheve promovionale në adresën e tyre elektronike.
- 2) Në zbatim të nenit 6 pika 1 germa ‘a’ të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të merret në mënyrë të qartë nga klientët që aplikojnë në websitin bookinae.com. pëlqimi për dërgimin e mesazheve promovionale në adresat e tyre elektronike
- 3) Të merret pëlqimi specifik për klientët aktual, duke i dërguar një kërkesë të qartë nëse pranojnë t’u dërgohen mesazhe promovionale në adresat e tyre elektronike. Të dhënat personale të klientëve që nuk pranojnë t’u dërgohen mesazhe promovionale ose nuk i përgjigjen kërkesës të fshihen nga sistemi që funksionon për dërgimin e mesazheve promovionale.
- 4) Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të kryhet brenda një afati kohor prej 45(dyzet e pesë) ditësh.

- 5) Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

